



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 314 Prot

Shkodër, më 12.02 .2020

VENDIM

Nr. 70 datë 12.02 .2020

**“ PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL,
PËR VITIN 2020 NË INSTITUCIONIN E BASHKISË SHKODËR , PJESË E
SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 8; gërmës b, nenit 9, të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar; të ligjit nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të VKM nr.108, datë 26.02.2014 “Për Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil”; të Vendimit nr. 07 dt. 20.01.2020 “Për miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër ”

VENDOSA :

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim në administratën e Bashkisë Shkodër, pjesë e shërbimit civil është gjithsej, sipas kategorive të mëposhtme:
 - Për kategorinë e mesme drejtuese 2 (dy)
 - Për kategorinë e ulët drejtuese 2 (dy)
 - Për kategorinë ekzekutive 15 (pesëmbëdhjetë)
2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, në kategorinë ekzekutive, janë si më poshtë:
 - Shkenca Juridike;
 - Shkenca Ekonomike;
 - Shkenca Kompjuterike;
 - Shkenca Shoqërore;
 - Shkenca Sociale;
 - Shkenca Mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
 - Inxhinieri;
 - Arkitekturë;
 - Gjeodezi;
 - Shkenca Edukimi;

3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerezore, në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

